

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

Rezyme e Temës

” ZHVILLIMI I ARSIMIT SHQIP NË VUSHTRRI ME RRETHINË GJATË VITËVE 1989-1999 ”

Kandidati : Avdi Mehmeti

PRISHTINË, 2021

Në kapitullin e parë gjendja e arsimit shqip në komunën e Vushtrrisë në dhjetëvjetshin e fundit të shekullit xx ka katër nënkapituj, në nënkapitullin e parë tek historiku i shkurtë i arsimit në komunën e Vushtrrisë, shpjegohet puna angazhimi, vështërsitë që kishte gjatë asaj kohe për ta mbajtur arsimin gjallë në territorin e Vushtrrisë. Po ashtu në këtë kapitull shihet gjendja, organizimi dhe arsimtarët së bashku me nxënës që janë dënuar nga okupatori dhe regjimi i asaj kohe nga viti 1989 deri në vitin 1999 e që nga organet arsimore të Kosovës, në kundërshtim me vendimet e organeve arsimore të Serbisë, janë miratuar planet dhe programet e reja mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm. Po ta kalosh këtë periudhë mendoi se nuk do të kemë një pasqyrë në përgjithësi, është një hyrje e temës.

Në kapitullin e dytë gjendja e arsimit shqip gjatë viteve 1994 - 1998 ka tre nënkapituj e që në nënkapitullin e parë flitet për organizimin e arsimit dhe masat e dhunshme në Vushtri vështërsitë ekonomike dhe politike, rrethanat e krijuara, dhunës dhe terrorit shtetëror të ushtruar: brutalitetit, fyerjeve, kërcënimeve mbi të gjitha rrahjet, burgosjet, alivanosjet e shpeshita sikur i bënë punëtorët e arsimit më të fortë ndaj çdo forme të dhunës. Ideali dhe gadishmëria e lartë e punëtorëve të arsimit, ka bërë të mundur ta mbijetojnë dhunën, ta zhvillojnë dhe ta realizojnë procesin mësimor me forca dhe mundësi të lejuara. Kushtet në të cilat është mbajtur mësimi e që e rëndonin veprimtarinë e arsimtarëve. Realizimi i planprogrameve mësimore me vështirësi, për shkak të represionit serb, i largonte ata nga efikasiteti dhe vullneti për punë ku në këtë kapitull shtjellohet hapësira e pamjaftueshme për realizimin e mësimi, shkurtimi i orëve mësimore, për shkak të hapësirës së pamjaftueshme, mungesa e teksteve shkollore, kushtet e rënda materiale (pagat jo të rregullta të arsimtarëve), prania e dhunës, hulumtimit nëpër shkolla dhe tema tjera që kanë të bëjnë me organizimin.

Në nënkapitullin e dytë që flitet për mësimdhënësit dhe kualifikimi i tyre pasqyrohet struktura kualifikuese e mësimdhënësve në bazë të niveleve, aktivitetet e lira, ambienti shkollorë, bashkëpunimi me prindër që në atë periudhë kanë funksionuar.

Nënkapitulli i fundit i kapitullit të dytë është ai i Lidhja së Arsimtarëve Shqiptarë – LASH- dhe ndërveprimi i saj me shkollat e Komunës së Vushtrrisë e që vëhet në pahë organizimi i tyre, përgjegjësitë e organizimit të procesit arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit e që ishte forca kryesore që përcaktoi dhe udhëhoqi zhvillimet e arsimit në Kosovë për një dekadë (1990-1999).

Kapitulli i fundit është procesi i zhvillimit të arsimit shqip pas luftës (1999 – 2000) që ndërthet në vete katër nënkapituj e në nënkapitullin e parë Organizimi i procesit mësimor vëhet në dukje mënyra e organizimit të mësimi në këtë periudhë lufte e pas lufte dhe vështërsitë që kishin akterët kryesorë.

Formimi i Këshillit Komunal të Arsimit është kapitulli i dytë që ka për shtjellim organin mbikqyrës që do të bënte organizimin dhe ato pak financime që merrnin mësimdhënësit dhe

mënyrën e inkasimit dhe organizimin në përgjithësi duke përfshirë edhe mbajtjen e rendit dhe diciplinën e sidomos në shkollat e mesme. Pra këtu bëhet fjalë për kupollen e arsimit që në mënyrë hierarkike të funksionoj sistemi arsimorë në Vushtrri.

Nënkapitulli i tretë Detyrat dhe obligimet e Këshillit Komunal të Arsimit (KKA-së) të kapitullit të tretë flet për punën dhe detyrat nga veprimtaria e arsimit në territorin e komunës përkatëse, mbikqyrte zbatimin e ligjëshmërisë dhe realizimin e planev-programeve mësimore në institucionet parashkollore, shkolla fillore dhe të mesme, organizoi themelimin dhe pavarësimin e shkollave fillore dhe të mesme, organizoi rrjetin, dhe emërtimin e institucioneve parafillore fillore dhe të mesme, organizoi hapjen e paraleleve parafillore fillore dhe të mesme, mbikqyrjen profesionale dhe pedagogjike në shkolla, kujdesej për organizimin, përfëshirjen dhe vijimin e nxënësve në shkolla.

Nënkapitulli i fundit dhe jo më pak i rëndësishmi është ai Lista e drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe përgjegjësve të arsimit për periudhën 1970-2002 e që nuk ishte edhe lehtë të punohet në këtë periudhë e prijësit e institucioneve arsimore ishin ata që bartën barrën dhe përgjegjësinë ku mund edhe të shihen me emër dhe mbiemër duke fillu nga shkollat fillore, shkollat e mesme, inspektorët e arsimit, referentët arsimorë, drejtorë/sekretarë të Sekretariatit për Veprimtari Shoqëror, e deri te Sekretarë të Bashkësisë arsimore më vonë të BVI-së për arsim dhe edukim Fillor.

Në fund është prërfundimi dhe literatura e nevojshme e përcjellur me fotografi.